

D. Agolli “Shkëlqimi dhe rënia e shokut Zylo”

fragment

Taqi tregon:

“Më vjen keq për shokun Zylo. Për një ditë është dobësuar e është zbehur në fytyrë. Sytë i janë thelluar dhe kapakë e tyre i janë mavijosur. Por ai është i fortë dhe kurrë nuk bie në pesimizëm; pesimizmin e urren. Motoja e tij e jetës është: optimizëm, optimizëm, gjithnjë optimizëm dhe jeta do të lulëzojë! E admiroj për këtë ndjenjë parimore! Me dhimbje shkova në spital për të vizituar xha Maksutin. Sa i thashë portierit se më kishte dërguar shoku Zylo, ai hapi të dy kanatat e portës dhe më lejoi, duke kërkuar ndjesë për ato dy minuta që më mbajti në këmbë.

Hodha krahëve një bluzë të bardhë, kalova nëpër korridorin e pavijonit dhe hyra në dhomën ku ishte shtrirë xha Maksuti. Ai ishte në një shtrat të pastër. Rreth tij ishin mbledhur pesë mjekë të kryesuar nga vetë drejtori i spitalit. Ata jepnin e merrnin me njëri-tjetrin, këshilloheshin dhe pyesnin xha Maksutin për gjithë sëmundjet që kishte kaluar që nga fëmënia e gjer më sot. Ai tregonte me një logjikë të mprehtë e të shëndoshë, që ia pata zili.

Unë iu afrova krevatit të tij dhe doja ta përqafoja, por mjekët nuk më lejuan. Ata më thanë të mos e shqetësoja me anën e të prekurit me dorë dhe me qafë.

- Si more, xha Maksut, na hidhërove të gjithëve? Gjithë zyrat e drejtorisë sonë vetëm për ju flasin! – thashë unë.

- S’ka gjë, pushteti të na rrojë! – tha xha Maksuti krenar, sikur të mos i kishte ndodhur asgjë.

-Të lumtë, xha Maksut! – tha drejtori.

Në këtë kohë erdhi shoku Zylo. Ai u dha dorën mjekëve dhe drejtorit, u ul te koka e babait, e puti lehtë në ballë dhe buzëqeshi.

- Nuk ju lëmë të dergji ju, që jeni lavdia jonë, - tha shoku Zylo. – Ti së shpejti do të ngrihesh baba! Ti je ngritur kur ke marrë pesë plumba në Luftën e Vlorës, jo të mos ngrihesh sot, në këtë mëngjes të bardhë. E si të mos ngrihesh sot që kemi me qindra spitale e mijëra mjekë. Shkuan ato kohë, kur njeriu vdiste edhe nga një grip i papërfillur! Ne do t’ju ruajmë si monumente, baba!

Xha Maksuti vuri buzën në gaz.

- Po rri, o Zylo! E si të mos ngrihem! Ka ardhur të më shohë gjithë Ministria e Shëndetësisë! – tha ai.

- Sot do të vinte vetë ministri, por pati një shërbim urgjent jashtë kryeqytetit, - tha shoku Zylo.

- Më bëhet qejfi që ke shokë kaq të mëdhenj, o Zylo! Ja, ky qejf po më shëron! – tha xha Maksuti.

- Baba, - tha shoku Zylo, - ti gjithnjë ke qenë modest dhe më ke këshilluar të jem i thjeshtë dhe kokulur. Pastaj edhe ata që ti i quan të mëdhenj, janë bij të dalë nga gjiri i masës dhe përfaqësojnë masën. Ja, drejtori – dhe i ra krahëve drejtorit të spitalit, - ky është një ndër ata bij të masës. Ne e rritëm dhe i dhamë shkollë... – kështu tha shoku Zylo dhe unë dëgjoja e mendoja për mençurinë e tij. Nga ana tjetër, unë vura re modestinë e shokut Zylo, që e ka pasur dhe e ka si parim themelor në jetën e tij të përditshme. E kuptoni ç’njeri është? Është fat për drejtorinë tonë që ka një njeri të tillë. Dhe ka njerëz që e kritikojnë shokun Zylo kot së koti! Ai është shpirt njeriu.

Ne ndenjëm edhe ndonjë orë dhe u ngritëm të dilnim. Shoku Zylo u dha porosi mjekëve. Pastaj bashkë me drejtorin kaloi nëpër pavijon dhe vizitoi shumë të sëmurë duke u interesuar për ta si për të atin. Të gjithëve u bëri përshtypje të madhe ky gjest fisnik.” – përfundoi tregimin e tij Taqi.

- Hë more, me këtë Maksut! Na çmende! – i tha Arianiti Taqit.

Taqi u zbeh dhe filloi të shikonte nga dera, sikur të kishte frikë se mos hynte shoku Zylo.

- Ai është i ati i shokut Zylo. Pastaj është veteran i Luftës së Vlorës, - tha Taqi.

- Ik more me gjithë Maksut e me gjithë Zylo! – tha Arianiti. – Veteran! Ai kurrë s’ka qenë në Vlorë! Nuk ka qenë as atëherë, as tani.

Taqi filloi të lëvizte buzët pa nxjerrë asnjë tingull.